



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për:	Haki Rugova , Kryetar i Komunës së Istogut Qaush Balaj , Kryesues i kuvendit të Komunës së Istogut	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Goran Rakić , Zëvendës Kryeminister dhe Ministër i MPL-së Trim Berisha , Z.v. Sekretar i Përgjithshëm i MPL-së	
Nga:	Venera Çerkini Udhëheqës e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 24/02/2021 Nr.43-111/1
Zyrtari përgjegjës	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave.	
Komisioni ndërministror për hartimin dhe vlerësimin e aktit	Sanije Dërguti, MPL Isah Rudaku, MBPZHR Sabrie Rama, MEA Mirvete Kelmendi, MSH Ardian Mehmeti, MD Krenare Sfishta, MPB	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Istogut	
Lloji i aktit:	Rregullore e Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Rregullore Nr.2/2021 për taksa, ngarkesa dhe gjoba
E miratuar më datë: 29.01.2021
E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 08.02.2021

Komisioni Nderministror i formuar nga MPL, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
	Rregullore Nr.2/2021 për taksa, ngarkesa dhe gjoba	Rregullore Nr.2/2021 për taksa, ngarkesa dhe gjoba, e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Istogut, është shqyrtuar nga ministritë përkatëse, e të cilat pas vlersimit kanë konstatuar se rregullorja është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi si vijon: Ministria e Shëndetësisë; Nëni 9 par.2 (2.18)), shërbimi shëndetësor, lëshimi i certifikatave mjekësore sipas kërkesës dhe çmimorja për certifikata, nuk është harmonizuar me Udhëzimin Administrativ Nr.04/2013 për Certifikatat shëndetësore dhe Shtojcën Nr.1 Çmimoren, dispozitat e të cilit udhëzim rregullojnë llojet e certifikatave shëndetësore, institucionet shëndetësore të cilat kanë të drejtë të lëshojnë certifikata sipas llojit të caktuar dhe çmimoren për këto shërbime. Gjatë implementimit nga Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Institucionet Shëndetësore të nivelit parësor, për vitin 2021, për shërbime shëndetësore tjera të cilat kryhen në nivel parësor dhe të cilat nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore vlejnë dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.04/2020 Kujdesi Parësor Shëndetësor. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural: Neni 11 të Rregullores bazike të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i nën paragrafit 1.4 fjalia "Certifikatë shëndetësore sipas llojit të kafshës sipas Urdh. Adm. Nr.17/2005 (MBPZHR) të zëvendësohet me fjalinë "Certifikata shëndetësore sipas llojit të kafshës të përcaktuar sipas Udhëzimit Administrativ (MBPZHR)-NR.14/2014 për Qarkullimin e Kafshëve të Gjalla Brenda Territorit të Kosovës, të datës 22.05.2014.

Neni 11 paragrafi 1 pas nën paragrafit 1.4 të shtohet me nën paragrafët e ri 1.4, 1.5 dhe 1.6, të bëhet kompensimi për shërbime profesionale për prerje të pyjeve private dhe taksa për kullotje të bagëtisë sipas Udhëzimit Administrativ MA - NR 12/2005 për caktimin e çmimeve - taksave për shfrytëzimin e produkteve pyjore - drunore, jo drunore dhe për shërbime profesionale - teknike dhe shtohen nën paragrafët si vijon:

1.5. Shërbimet profesionale për prerje të pyjeve private:

1.5.1.	Dru Zjarri për m3	-----	1.50€
1.5.2.	Dru Zjarri mbi 7m3	-----	2.00€
1.5.3.	Dru Teknik m3	-----	2.50€

1.6. Taksa për kullotjen e bagëtisë (për një (1) vit:

1.6.1.	Gjedhe mbi një vjet	copë.....	1.20€
1.6.2.	Viçat.....	copë.....	0.80€
1.6.3.	Delet.....	copë.....	1.20€
1.6.4.	Qengjat.....	copë.....	0.80€
1.6.5.	Kuajt dhe gomarët.....	copë.....	1.90€
1.6.7.	Derrat.....	copë	1.60€
1.6.8.	Derrkuca.....	copë.....	0.90€

Ministria e Punëve të Mbrendshme:

Sipas kërkesës tuaj, gjeni si më poshtë përgjigjen nga MPB-ja, të pranuar nga DSHAM-ja, AME-ja dhe ARC-ja, sa i përket Rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba për vitin 2021 - KK Istog

Divizioni për Shtetësi - DSHAM/DSH

Ne nenin 2 paragrafi 2 nënparagrafi 2.9 dhe 2.10 nuk e kemi të qartë se për çfarë bëhet fjalë "vërtetim për humbje të shtetësi dhe vërtetim për pranim të shtetësisë" nuk ka bazë ligjore që organi komunal mund të lëshoj ndonjë vërtetim me këtë emërtim, pasi që akti i vetëm dhe i fundit për humbje të shtetësisë është vendimi i Divizionit për Shtetësi. Pra, është në kundërshtim, me Ligjin për Shtetësi dhe si e tillë duhet të largohet nga Rregullorja.

Agjencisë e se Menaxhimit Emergjent - AME

Me kujdes kemi analizuar dhe shqyrtuar Rregulloren e KK Istog, pas vlerësimit konstatojmë se neni 10 pika 8, 9,10 dhe 11 të kësaj Rregullore nuk është në harmoni dhe bie në kundërshtim me fushëveprimin dhe kompetencat e përcaktuara në Ligjin për Mbrojtje në Zjarri , si dhe Vendimit të Ministrit të MPB nr 423/ 2010 pasi që kjo pjesë është kompetencë të Agjencisë se Menaxhimit Emergjent.

ARC/DGJC

Sa i përket Rregullores së Komunës së Istogut, emërtimet e dokumenteve të gjendjes civile, në përgjithësi janë në rregull.

Neni 2 te pika 4.2 Deklarata e bashkësisë familjare te zëvendësohet me "Deklaratë për bashkësinë familjare" (sipas UA Nr. 24/2015)

Neni 2: pika 1.6 shkurtesa LAM te zëvendësohet me "Regjistri i Martesës"

Propozojmë që në kuadër të kësaj rregulloreje, te vendosen konform ligjit për gjendjen civile, masat ndëshkuese siç parashihen në Ligji Nr. 04/L -003 për Gjendje Civile,

Neni 63 Gjobat:

1. Me gjobë dënohet personi për këto shkelje:

1.1. prej njëzet (20) deri pesëdhjetë (50) Euro kur nuk paraqet lindjen e fëmijës në afatin e paraparë me këtë ligj;

1.2. prej pesëdhjetë (50) deri njëqind (100) Euro kur nuk e lajmëron vdekjen në afatin e caktuar sipas këtij ligji;

1.3. prej njëzet (20) deri pesëdhjetë (50) Euro kush kryen varrimin pa leje.

Zbatimi i nenit paragrafit 1.1 dhe 1.2 është i rregulluar me Udhëzimin Administrativ Nr. 24/2015 për regjistrimin e mëvonshme, ku për secilin regjistrim të mëvonshëm kërkohet fletëpagesa që dëshmon pagesën e gjobës ashtu siç përcaktohet në nenin 63 të këtij ligji.

Ministria e Drejtësië

Gjobat e përcaktuara në nenin 12 të Rregullores në fjalë janë në përputhje me Ligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtjet.

Ndërsa, afati për pagimin e tyre (8 ditor) i përcaktuar në nenin 13, (paragrafi 1) të Rregullores është në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtjet. Prandaj, i njëjti duhet të harmonizohet me nenin 30, (paragrafi 1) të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, i cili përcakton si në vijim: "Në vendimin për kundërvajtje, me të cilin përcaktohet afati i pagimit të gjobës, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë, dhe më i gjatë se nëntëdhjetë (90) ditë nga data e formës së prerë të vendimit, ndërsa në rastet e arsyeshme, varësisht nga lartësia e dënimit me gjobë dhe gjendja ekonomike e të pandehurit, organi i kundërvajtjes apo gjykata mund të përcaktojë që sanksioni kundërvajtës, i shqiptuar me gjobë të paguhet në këste, por që afati i pagesës nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë (6) muaj."

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit:

Përcaktimi i vlerës së Tarifës për tu pajisur me leje mjedisore komunale (LMK) në nënin 3, paragrafi 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Nr.2/2021, nuk është në përputhje me Udhëzimin Administrativ për Leje Mjedisore Komunale Nr.01/2017

Përcaktimi i vlerës së Tarifës për t'u pajisur me leje mjedisore komunale, të jetë në përputhje me nënin 15, paragrafi 1 nenparagrafi 1.1 dhe 1.2 të Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore Komunale Nr.01/2017.

Taksat për leje ndërtimore të aplikuara në këtë rregullore (janë aprovuar nga MMPH në vitin 2013) bazuar në nënin 22 të ligjit për ndërtimin në fuqi paragrafi 1.1 ligjërisht janë në rregull.

Mirëpo, nga viti 2013 e deri në vitin 2021 situata sa i përket lëshimit të lejeve të ndërtimit do të duhet të jetë më ndryshe sipas parimit të kostos reflektive në të cilin parim bazohet ligji në fuqi për Ndërtimin dhe Udhëzimi Administrativ nr. 02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrërimi dhe tarifatat për rregullimin e infrastrukturës (tutje: U.A. 02/2018). Ky udhëzim Administrativ është në fuqi nga viti 2018 dhe mund ta gjeni në linkun:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16479>

Në nënin 14 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018 për Taksat Administrative për Leje Ndërtimore, Leje Rrërimi dhe Tarifatat për Rregullimin e Infrastrukturës shprehimisht thuhet: "Nëse komuna vendos që taksa aktuale të zbatohet e njëjta edhe për vitin pasues, atëherë dërgohet shkresa sqaruese nga komuna në Ministri. Mostra është dhënë në Shtojcën 10", (një kërkesë e tillë asnjëherë nuk ka ardhur në MEA).

Komuna juaj akoma nuk ka dorëzuar për miratim në Ministri propozimin për taksa.


Bazuar në nënin 14 paragrafi 2 të U.A. 02/2018, shprehimisht thuhet "Nëse komuna vendos që taksa aktuale të zbatohet e njëjta edhe për vitin pasues, atëherë dërgohet shkresa sqaruese nga komuna në Ministri. Mostra është dhënë në Shtojcën 10", (ndërsa një kërkesë e tillë nuk është dërguar në Ministri/MEA nga ana juaj).

Andaj, i rekomandojmë Komunës, që propozimin e taksave për leje ndërtimore për vitin 2022 së bashku me tabelat/shtojcat e plotësuara t'a dërgojë në MEA për aprovim në fund të vitin 2021 (~ muajin Shtator), ashtu si e përcakton Udhëzimi Administrativ nr. 02/2018 për

	Taksat Administrative për Leje Ndërtimore, Leje Rrërimi dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës. Në nenin 4 të kësaj rregullore janë të cekura vetëm udhëzimet administrative: Udhëzimi Administrativ MMPH – Nr. 11/19 për ndarjen e ndërtesës dhe të pjesës së ndërtesës; Udhëzimi Administrativ MMPH – Nr. 12/19 për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës dhe Udhëzimi Administrativ (MEA) Nr. 09/2020 për tarifat e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme. Mirëpo, edhe UA-të e theksuara më lartë nuk janë të shënuara ashtu siç i kanë emërtimet.
--	---

Bazuar në të cekurat më lartë, Komisioni Nderministror i formuar nga Ministria e Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së Istogut që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për:	Lulzim Ejupi, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave Gentiana Islamaj, Zv. Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë Ardian Mehmetaj, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë Agim Berdyna, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Izedin Bytyqi, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës Fatos Qerimi, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit Ardian Bajraktari, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë Hasan Sejfiu, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Iber Alaj, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit	
Kopje:	Kryetari i Komunës së Istogut Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL	
Përmes:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MPL	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 09.02.2021 Nr.43-111
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari përgjegjës Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës 2. Zyrtari përgjegjës Sanije Dërguti, Zyrtare e lartë për monitorim të hartimin e Komunave për shkresës përcjellëse	
Lënda:	Kërkesë për shqyrtimin e ligshmërisë së aktit të Komunës së Istogut	
Lloji i aktit:	Rregullore e Kuvendit të Komunës	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Rregullore Nr. 2/2021 për taksa, ngarkesa dhe gjoba, e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Istogut, dhe e nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Istogut, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Rregullore e Kuvendit të Komunës së Istogut, për taksa, ngarkesa dhe gjoha

I miratuar më datë: 29.01.2021

I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 08.02.2021



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

01 Numër: 13/2020
Data: 29.01.2020




Komuna e Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

<http://kk.rks-gov.net/istog>

Rregullore Komunale Nr. 2/2021

KUVENDI I KOMUNËS



RREGULLORE
KOMUNALE PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA

Janar/2021

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 12.2 pikë c), dhe nenit 49 paragrafi 49.2 të Ligjit për Vende
 Liria Nr.23/2008 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.23/2008), nenit 8 të Ligjit për Lirë
 Peshë Nr.49/2009 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27/2008) dhe nenit 1
 33 paragrafi 1 dhe 6 dhe neni 34 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Istogut nr.62/2010, Kuvendi i
 Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.01.2011 miratoi këtë:

RREGULLORE KOMUNALE PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen të gjitha të hyrat komunale duke përfshirë taksat për kryerjen e shërbimeve
 të tilla si ngarkesat dhe gjobat e ndryshme të cilat do të arkëtohen nga Drejtoria Komunalet.

Neni 2 Drejtoria për Administratë

Funksionimi dhe përfshirimi i dokumenteve

1. Regjistrimi në Gjendjen Civile

1.1. Kompletimi i dosjes për aplikim të lirin dhe fitim të shtetësisë;

1.2. Lidhja e martesës jashtë institucionit dhe jashtë orarit të punës;

1.3. Lidhja e martesës jashtë orarit të punës brenda institucionit;

1.4. Lidhja dhe regjistrimi i martesës në "Regjistrin i Martesës" me procesverbal;

1.5. Lidhja dhe regjistrimi i martesës në "Regjistrin i Martesës" me shtetësinë e huaj me
 procesverbal;

1.6. Marrja e Aktvendimit mbi ndryshimin e emrit personal në "Regjistrin i Lindjes" dhe
 1 AM;

1.7. Përcaktimi i gërmëzimit të emrit personal;

1.8. Anulimi i regjistrimit të lindjeve në dy komuna;

2. "Lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile"

2.1. Eksaktimi nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile

2.2. Certifikata e lindjes;

2.3. Certifikata e martesës;

2.4. Certifikata e vdekjes;

2.5. Certifikata e Gjendjes Martesore";

2.6. Nënshkrimi nga ardhja;

2.7. Certifikata e vendbanimit;

2.8. Certifikata e shtetësisë;

2.9. Vërtetimi për lirin e shtetësisë;

2.10. Vërtetimi për lirin e shtetësisë;

3. Vërtetimet e gjendjes civile

- 3.1. Vërtetimi i një konfirmimi të emrit personal;
- 3.2. Vërtetimi i një mjeteve për jetesë;
- 3.3. Vërtetimi i nënshkrimit për shkrimin dhe dorëshkrimin;
- 3.4. Vërtetimi i ndryshime;
- 3.5. Nënshkrimi i vendimit nga shteti i huaj për ndryshim të emrit.

4. Vërtetimi i deklarativave

- 4.1. Deklarata e bashkësisë familjare;
- 4.2. Deklaratë e gjendjes personale të personit fizik;
- 4.3. Deklaratë e shpërblimit dhe përshkrimit të punës (Aktivitetja);
- 5. Përpilimi dhe parashkrimi i shkrësive-kërkesave
- 5.1. Parashkrimi i kërkesave të ndryshme drejtuar organeve komunale
- 5.2. Referencat për operatorin ekonomik

Neni 3

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

1. Dhënia e akteve për kushte tekniko-urbanistike për zonat që nuk kanë plan rregullues urban

1.1. Për parashkrimin e punës Es.

1.2. Mures tretimese;

1.3. Për objekte të përkohshme-afariste;

1.4. Për objekte ndihmëse;

1.5. Për garazhet;

1.6. Kërkesa për shfrytëzimin të dokumentacionit të shërbimeve Pronësoro-Juridike për banesat;

1.7. Për vëzhgimin e Lejes për ndërtim dhe lëshimi i LN duplikat;

1.8. Vërtetime dhe pajtim të ndryshme

2. Taksat për leje ndërtimi,

2.1. Për ndërtimin e objekteve të të gjitha llojeve;

2.2. Tarifa rregullative për destinim të infrastrukturës për objekte për banim ($10^2 \cdot 50 \cdot 99,87$ push. ($100/50 \cdot 99,87 = 199,746$;

3. Lëshimi i lejes komunale mjedisore sipas UA Nr.01/2017

3.1. Tarifat në vlerën investive të projektit deri 25,000 euro

3.2. Tarifat në vlerën investive të projektit mbi 25,000 euro

3.3. Lëshimi i lejes për leje përdorimi për objekt individual sipas banimit;

3.4. Lëshimi i lejes për leje përdorimi për objekt shumëbanesor për çdo banesë;

3.5. Lëshimi i certifikatës së përdorimit për lokale afariste brenda objektit shumëbanesor;

3.6. Lëshimi i certifikatës së përdorimit për lokale afariste individuale;

- 3.7. Leje për instalim të certifikatës së përdorimit për lokale objektive industriale.
- 3.8. Leje për instalim të certifikatës së përdorimit për hotele, motele dhe restorante.
4. Leje tjera
- 4.1. Leje për vendosjen e telefonave telefonike;
- 4.2. Leje për shkrimin e rrjetit kabllo (ajror) të internetit për metër gjatësi;
- 4.3. Leje për shkrimin e rrjetit elektrifikues për metër gjatësi;
- 4.4. Leje për vendosjen e armatimeve shpërndanëse MDF, për copë;
- 4.5. Leje për ndërtimin-vendosjen e trafave elektrike;
- 4.6. Leje për vendosjen e antenave;
- 4.7. Leje për përdorim nëmtesorë: kanalizim, ujësjellës, rrjet kabllo elektrike, rrjet kabllo të internetit, për metër gjatësi.
4. Kompensimi për tokën ndërtimore në zonat urbane të cilën Komuna e ka dhënë në shfrytëzim të përkohshëm paguhet (për një muaj)
- 4.1. Sipërfaqja prej 1-10 m².
- 4.2. Sipërfaqja prej 11-30 m².
- 4.3. Sipërfaqja prej 31-50 m².
- 4.4. Sipërfaqja mbi 51 m² në lartësi prej.
5. Taksa për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike përkohësisht (prej 0-3 vit)
- 5.1. Vendosi e tezgave lëvizëse dhe objekteve tjera të vogla të përkohshme-sezonale në të cilat kryhet veprimtaria tregtare, reklamim malli e të tjera shfrytëzimi një ditë;
- 5.2. Vendosi e tezgave lëvizëse dhe objekteve tjera të vogla të përkohshme-sezonale në të cilat kryhet veprimtaria tregtare, reklamim malli e të tjera shfrytëzimi një javë;
- 5.3. Vendosi e tezgave lëvizëse dhe objekteve tjera të vogla të përkohshme-sezonale në të cilat kryhet veprimtaria tregtare, reklamim malli e të tjera shfrytëzimi një muaj;
- 5.4. Leje për vendosjen e tavolinave para lokaleve hotele, terave për m² -mujore
6. Vendosi e pllakateve reklamuese në hapësira publike tarifa (mujore) për m²
- 6.1. Plakatat;
- 6.2. Plakatat reklamuese me ndriçim;
- 6.3. Vendosi e reklamave elektronike reklamuese;
- 6.4. Vendosi e reklamave në muret e ndërtesave publike
- 6.5. Vendosi e banerave-mujore
7. Ngarkesat për organizimin e lodrave argëtuese, të fatit dhe lojërave argëtuese automatike të ndryshme.
- 7.1. Vendosi e aparatëve për lojëra argëtuese, ngarkesa mujore për çdo aparat sipas llojit;
- 7.2. Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e objekteve argëtuese (purdve argëtuese). Tarifa mujore për m²
8. Shërbime tjera
- 8.1. Shfrytëzimi i hapësirave të ndërtesave në pronësi të komunës për m² në muaj
9. Taksa për trajtimin të ndërtimeve pa leje (Ligji 06/L-024)
- 9.1. Taksa për legalizimin të ndërtimeve pa leje të kategorisë I dhe ndërtimeve pa leje të kategorisë II që janë shpallur si një euro për metër katror m²
- 9.2. Taksa për legalizimin e lejeve vijuese të ndërtimeve pa leje është dy euro për metër katror për m²

9.2. Indërtimet e Llogarit 0 të cilat nuk janë shpejt për m2

9.2.2. Niveli i cili në indërtimet nie lejt për m2

Neni 4

Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi

1. Tarifat e shërbimeve dhe produkteve kadastrale rregullohen sipas Udhëzimit Administrativ 11/19 MMPH për ndarjen e Ndërtësës dhe të pjesës së Ndërtësës

2. Udhëzimi Administrativ nr. 12/2019 për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës
Tarifat për dhënien e informatave nga Sistemi i Informacioneve Kadastrale të Lokave të Kështjës nga ZKK-të

3. Tarifat e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme bëhen sipas LA të MFA nr. 09 /2020

Neni 5

Drejtoria për Buxhet e Financa

Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve

1. Dhënia e certifikatave

1.1. Dhënia e Certifikatave mbi gjendjen ekonomike:

2. Taksa për Automjetet Motorike

2.1. Për automjetet që peshon deri në 3.5ton.

2.2. Për automjetet mbi 3.5 ton.

Neni 6

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim

Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve

1. Për pije alkoolike

1.1. Taksa vjetore për lejinin e përdorimit të pijeve alkoolike për hotele dhe motele:

1.2. Taksa vjetore për lejinin e përdorimit të pijeve alkoolike për Kafiteri dhe restorante dhe në lokale të ndryshme:

2. Taksa për punë për punë jashtë orarit të rregullt

2.1. Taksa për një orë punë të veprimtarive turistike

2.2. Taksa për një orë punë të veprimtarive hoteliere

2.3. Tabela për një ditë pune të veprimtarive zejtare

2.4. Tabela për një ditë pune të veprimtarive shërbuese

Neni 7. Drejtoria për Arsim

Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve

1. Partecipimet për vijim të fëmijëve në kopshte
 - 1.1. Partecipimi në baza mujore për kopshte të familjeve në Istog.
 - 1.2. Partecipimi në baza mujore për kopshte të fëmijëve në Gjakovë dhe Banjë
 - 1.3. Partecipimi në baza mujore për kopshte të fëmijëve në Vrgjës dhe Rakosh.
2. Partecipimi për mësimin informal
 - 2.1. Për vazhdim të vitit;
 - 2.2. Për vijimin e mësimit praktik;
 - 2.3. Për provimet përfundimtare të klasave-certifikat;
 - 2.4. Për diplomë të përfundimit të shkollimit;
 - 2.5. Provimet diferencial
3. Pagesat për dokumentacionit shkollor
 - 3.1. Pagesa për nxjerrjen e diplomës duplikat;
 - 3.2. Pagesa për nxjerrjen e dëftesës duplikat;
 - 3.3. Certifikata për kryerjen e ciklit IIIor 1-5 duplikat;
 - 3.4. Certifikata për kryerjen e nivelit 6-9 duplikat;
 - 3.5. Certifikata për kryerjen e arsimit të obliguar duke përfshirë dy nivelet 1-9 duplikat;
 - 3.6. Vërtetimet e nënshkrime të cilat i kërkojnë ishxënësit (palët) si në arsimin e obliguar ashtu edhe në arsimin e mesëm të lartë;
 - 3.7. Për dëftosat e lëshuara kandidatëve që kanë të kryer shkollimin e obliguar sipas sistemit të vjetër të arsimit.

Neni 8 Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport

1. Shfrytëzimi i hapësirës në Sh.K. "Adem Jashari"
 - 1.1. Salla e madhe e koncerteve fitimprurëse për një mbrëmje;
 - 1.2. Halli për intronjë rinore (një muajt);
 - 1.3. Salla e gjelbër (për një ditë);
 - 1.4. Anëtarësimi në bibliotekë për nxënës deri në klasën e nëntë.
 - 1.5. Anëtarësimi në bibliotekë për të gjithë të gjerë.
 - 1.6. Dënia në shfrytëzim e hapësirave rreth shtëpisë së kulturës në muajore
 - 1.7. Dënia në shfrytëzim e zyrave në shtëpinë e kulturës në muajore
2. Shfrytëzimi i tereneve dhe hapësirave rekreative-sportive;(me pak se një vit)
 - 2.1. Dënia në shfrytëzim e palestrës së sportive - muajore për klubet e licencuara të

komitës së bashku

2.2 Dhënia në shfrytëzim e hapësirave rreth sallës së sportive - m² majore për klubet e licencuara të Komitës së Istogut

2.3 Dhënia në shfrytëzim e stadiumit të qytetit - majore për klubet e licencuara të Komitës së Istogut

2.4 Dhënia në shfrytëzim e palestres së sportive - për një orë

2.5 Dhënia në shfrytëzim e 10 pestrave rreth sallës së sportive - m² majore

2.6 Dhënia në shfrytëzim e stadiumit të qytetit - për një orë

Neni 9

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mbrojtje Sociale

Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve të shërbimit	Shuma
1. Lëshuarja e vërtetimeve dhe shkresave të ndryshme nga Drejtoria	
1.1. Vërtetim për lirin nga participimi;	1
1.2. Vërtetim për arsyetimin e shpenzimeve të varrimit për botën e jashtme;	3
1.3. Përqasja sanitar për licencim të ordinancave private;	10
1.4. Kërkesa të ndryshme të palëve;	3
1.5. Vërtetimi që nuk kanë sigurim shëndetësor në Kosovë;	1
1.6. Formular për shërbim të famijëve në botën e jashtme;	1
1.7. Raport për inspektimin sanitar;	10
1.8. Lete për Ekshuminim të Kuqomave;	50
2. Qmarrja e bashkë pagesave për shërbime shëndetësore në nivelin parësorë, sipas Udhëzimit Administrativ 4/2007 të Ministrisë së Shëndetësisë	
2.1. Ekzaminimi mjekësor në punkt, QMF ose në QKMF, pa analiza laboratorike ose pa procedurë plotëse diagnostike me aparaturë;	1
2.2. Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF me udhëzim të Mjekut të Familjes;	2
2.3. Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF pa udhëzim të Mjekut të Familjes;	5
2.4. Ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente;	6
2.5. Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatore publike;	0.30
2.6. Ultrazëri standard;	2
2.7. Radiografia;	2
2.8. EKG;	0.30
2.9. Aratiba laboratorike-vetëm hemogrami dhe urina;	1
2.10. Analiza laboratorike komplete;	3
2.11. Caktimi i sheqerit në gjak në glikometër, sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore;	1
2.12. Audiograma;	
2.13. Shpëlarja e vesit;	
2.14. Dhënia e injeksionit intramuskular në shtëpi, përpos në rastet emergjente;	
2.15. Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente;	
2.16. Përpunimi i plagëve me tepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës, vetëm në vizitën e parë;	

- 2.17. Të raportojë me rregullime të institucione shëndetësore;
- 2.18. Të marrin dhe t'ju kthejnë mjekut e lëshuar sipas kërkesës së shërbimeve të shëndetësore;
- 2.19. Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shërbimeve të shëndetësore;
- 2.20. Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shërbimeve të shëndetësore për shtetasit e huaj;
- 2.21. Të marrin shërbime shëndetësore gjatë aktivitetëve sportivë për lloj;
3. Qmimoria e pagesave për shërbime stomatologjike të nivelit parësor-QKMF të Komunave dhe QMF
- 3.1. Vizita e parë stomatologjike;
- 3.2. RTG i dhëmbit;
- 3.3. Mbrojtja e përherëshme me amalgamë;
- 3.4. Mbrojtja e përherëshme me kompozitë;
- 3.5. Shërbimi i dhëmbit me mbushje të përherëshme (amalgamë apo kompozitë);
- 3.6. Amputimi vital i pulpës me mbushje të përherëshme (amalgamë apo kompozitë);
- 3.7. Ekstrahimi vital i pulpës me mbushje të përherëshme (amalgamë apo kompozitë);
- 3.8. Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përherëshme (amalgamë apo kompozitë);
- 3.9. Ekstrahimi mortal i pulpës me mbushje të përherëshme (amalgamë apo kompozitë);
- 3.10. Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përherëshme (amalgamë apo kompozitë);
- 3.11. Rëndetja konservativ e dhëmbit me mbushje të përherëshme;
- 3.12. Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës;
- 3.13. Fluorizimi i dhëmbëve sipas seanceve;
- 3.14. Vulosja e dhëmbëve;
- 3.15. Mënjimi i depozitimeve të buta;
- 3.16. Mënjimi i depozitimeve të forta (heqja e gurësve të dhëmbëve me ultrazh);
- 3.17. Kurazimi i shëpave parodontal (një dhembë);
- 3.18. Njëqindë dhëmbë;
- 3.19. Incizioni infra dhe extra oral;
- 3.20. Heqja e kurorës me anë të prerjes;
- 3.21. Riparimi i porcelan;
4. Shfrytëzimi i Autoambulancës me kërkesë të klientit pa referim të mjekut e që nuk janë raste Emergjente
- 4.1. Relacioni Istog-Prishtinë;
- 4.2. Relacioni Istog-Prishtinë;
- 4.3. Relacioni Istog-Tiranë;
- 4.4. Relacioni Istog-Shkup;
5. Qmimoria e Pagesave për Shërbime në Qendrën Sociale
- 5.1. Certifikata që nuk është hequr zotësia e Vërmimit e vlefshme për 1 vit.

2.2. Qësimi i të shtatë obligime ligjore (Alimentacion) ndaj personave përfshijë ligjet për llogji të tërësuesish të Republikës së Kosovës.

2.3. Nënstandin që posedon mjete material për ekzistencë (për marrje të nënshtrësish të Republikës së Kosovës).

2.4. Përqimi për bashkim familjar në botën e jashtme.

2.5. Qësimi i të shtatë obligime ligjore për edukim dhe shkollim

10

Neni 10

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

Shërbime/aktivitetet	Shuma
1. Lejet për ndërrhyrje në infrastruktura dhe hapësira tjetër publike	
1.1. Leje për montim e asfalt në rrugë dhe trotuare për 1m ² .	
1.2. Leje për prapjen e rrugëve dhe trotuareve të pa asfaltuara, parqeve, kufirave të betonit, betonit për 1m ² .	
2. Shërbime tjera	
2.1. Leje për vendosjen e materialit ndërtimor, druve, thengjillit etj. në hapësirat publike për 24 orë.	10
3. Leje për bllokim të rrugës (shiritit rrugor-trotuarit)	
3.1. Zona urbane-12 orë.	
3.2. Zona urbane-24 orë.	
3.3. Leje për ndalje ngarkim shkarkim të mallrave në rrugë dhe trotuar, në ato vende ku nuk pengohet komunikacioni, për 1 ditë.	10
3.4. Leje për ndalje ngarkim shkarkim të mallrave në rrugë dhe trotuar, në ato vende ku nuk pengohet komunikacioni, për 1 muaj.	20
3.5. Leje për ndalje ngarkim shkarkim të mallrave në rrugë dhe trotuar, në ato vende ku nuk pengohet komunikacioni për 1 vit.	30
3.6. Leje për auto taxi 4+1 ulës, për 1 vit.	20
3.7. Leje për kombi bus 8+1 ulës (Leje e veçantë për transportin e nxënësve të mësimin filior), për 1 vit.	10
3.8. Vënimin i Lejes për auto-taxi (nënshtrëhet kur nga pronari ndërrohet automjeti para skadimit të lejes që është pajisur me parë).	10
3.9. Vënimin i renditës udhëtimit për linjën e rregullt të udhëtareve dhe për transport të veçantë. Operatori transportues paguan taksën për një vit (për një relacion-nisje të caktuar).	15
